

VENDIM
Nr.267, datë 5.3.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I FUSHËS SË
MBETJEVE URBANE, PESHKOPI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i fushës së mbetjeve urbane, në qytetin e Peshkopisë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Peshkopi.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 8 000 m², tokë/arë, e vlerësuar me 400 lekë/m², me vlerë shpronësimi 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 99 000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga bashkia Peshkopi.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit mars 2008.
 7. Bashkia Peshkopi të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë bashkisë Peshkopi, dhe ata, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë, pranë subjektit kërkues, bashkia Peshkopi.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkia Peshkopi për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I
NDËRTIMIT TË FUSHËS SË MBETJEVE URBANE, PESHKOPI


Nr.	Emri	Sipërfaqja/ tokë arë	Çmimi l/m2	Vlera në lekë	Shënime
1.	Bedri Fiqiri Shehu	3685	400	1 474 000	Plotësim dokumentacioni
2.	Baftjar Bajram Zajmi	3015	400	1 206 000	Proces regjistrimi
3.	Emin Begu	630	400	252 000	Proces regjistrimi
4.	Hashim Shehu	670	400	268 000	Proces regjistrimi
	Shuma	8000	400	3 200 000	

Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë.



LOKALIZIMI KADASTRAL
FUSHËS SË MBETURINAVE
URBANE PËR QYTETIN E PESHKOPISË
SH. 11/2500

K-34-77-(254-D)



"MIRATOHET"

PRYETARI I K.R.R.T. TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

/ ILIR META /

MINISTRI I BUJQËSISË dhe USHQIMIT

/ LUFTER XHUNETI /

PREFEKTI I QARKUT DIBER

/ HAJREDIN TAHIRI /

